



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 63, DATË 21.08.2020

PËR
RINOVIMIN E LICENCËS PËR RITRANSMETIMIN E PROGRAMIT AUDIO ME
PËRSËRITËS “RADIO RFI”

Në mbështetje të nenit 5 dhe nenit 19, pika 16 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisë të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, nenit 41/1 dhe 41/2 të rregullores “Për procedurat dhe kriteret e dhënies së licencës së transmetimit audio, miratuar me vendimin e AMA-s nr. 153, datë 18.07.2016, i ndryshuar si dhe pas shqyrtimit të aplikimit nr. 4506/1 prot., datë 11.12.2018, të paraqitur nga Ambasada Franceze në Shqipëri, për rinovimin e licencës për ritransmetimin e programit audio me përsëritës “Radio RFI”, Autoriteti i Mediave Audiovizive,

VENDOSI:

1. Rinovimin e licencës, për ritransmetimin e programit audio me përsëritës “Radio RFI”, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.
2. Reduktimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit nga “*Bashkitë Tiranë, Durrës, Kamëz, Shijak, Vorë, qytetet Shkodër dhe Korçë*”, në “*Bashkitë Tiranë, Durrës, Kamëz, Shijak dhe Vorë*”, me karakteristikat teknike, sipas Aneksit nr. 1, bashkëlidhur.
3. Heqjen e të drejtës së përdorimit të frekuencave, në pikat e transmetimit Korçë (102 MHz) dhe Tarabosh (103.5 MHz)
4. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim i shtrin efektet prej datës 12.04.2018.

Kryetar:	Gentian	SALA
Zëvendëskryetar:	Sami	NEZAJ
Anëtar:	Agron	GJEKMARKAJ
	Gledis	GJIPALI
	Suela	MUSTA

ANEKSI NR. 1

Karakteristikat teknike të transmetimit

Page | 2

<i>Zona e shërbimit</i>	<i>Pika e transmetimit</i>	<i>Frekuenca MHz</i>	<i>Koordinatat XYZ</i>	<i>Fuqia Nominale (W)</i>	<i>Përforcimi i antenës (dBi)</i>	<i>ERP (W)</i>	<i>Azimuth (deg)</i>	<i>Lartësia e antenës (m)</i>	<i>Drejtimi i antenës</i>
Bashkitë Tiranë, Kamëz, Vorë, Durrës, Shijak	Fushë Dajt	102	19.54798 41.21647 1109 4DMD	300	6	578.46	255	5	D